



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departament Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr.14/2020

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryes, Diellza Hoxha dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat _____ si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tashje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore _____ i dyshuar për një varg shkeljesh disiplinore nga neni 48 par 2 të LPP, në seancën dëgjimore publike në të cilën prezentuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, zqj. Fadilete Hoxha, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, dhe përmbaruesit privat, pas mbajtjes së seancës së këshillimit dhe votimit të mbajtur me datën 27.08.2020, unanimitisht mori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamentit për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, nr DPL-14/2020, dt 13.07.2020, si dhe ankesa nga pala ankuese- _____ dt 25.06.2020, si të pa bazuara.
- II. Organi përmbarues-Përmbaruesi Privat _____ nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore nga neni 48 par 2 të LPP-së në lëndën përmbarimore P.nr 258/20.

A r s y e t i m

Me datën 06.07.2020, pala ankues _____ ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat _____ si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore _____ për shkak se _____

i njëjti ka kryer një varg shkeljesh disiplinore me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore në lëndën P. nr 258/20; me urdhërin për përmbarim të datës 06.03.2020 është lejuar përmbarimi në bazë të aktgjyqimit të plotëfuqishëm vetëm pak ditë para shpalljes së gjendjes emergjente nga Qeveria e Republikës së Kosovës për shkak të situatës me pandeminë COVID 19 dhe për rrjedhojë pala ankuese nuk ka pasur mundësi që të disponoj prapësim me vërejtje lidhur me propozimin për përmbarim; bazuar në njoftimet nga Mediat, Ministria e Drejtësisë kishte marrë vendim që të gjitha afatet ligjore në procedurë gjyqësore apo përmbarimore do të ndërpriten dhe nuk do të bëhet bllokimi i llogarive të debitorëve apo tërheqja e mjeteve në llogaritë bankare po që se nuk i kanë deponuara prapësimet apo ankesat e tyre; menjëherë pas heqjes së kufizimeve për qarkullim nga ana e Qeverisë, ai si debitor ka kryer obligimet e tij por përmbaruesi privat kishte bllokuar llogarinë e tij bankare në kundërshtim me nenin 48 par 2 të LPP që përcakton që përmbarimi mbi bazën e dokumentit të besueshëm nuk mund të kryhet para se të marrë formë të prerë aktivndimi për përmbarim.

Me datën 24.07.2020, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesionet të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komision propozimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat _____, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore _____ i dyshuar për shkelje disiplinore nga neni 48 par 2 të LPP-së, me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore në lëndën P.or 258/20.

Përmbaruesi privat në përgjigjen e tij me shkrim deklaron që ka ndërmarr veprimet ligjore në përputhje me autorizimet ligjore dhe kompetencat e përcaktuara me nenin 3 par 1 lidhur me nenin 341 të LPP-së. Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 48.2 të LPP-së, përmbaruesi privat thekson, që kompetenca për adresimin e prapësimit, bien në gjykatë, në pajtim me nenin 5 par 5 të LPP-së. Sidoqoftë, ky pretendim nuk qëndron sepse përmbarimi është iniciuar mbi bazën e aktgjyqimit të formës së prerë dhe të ekzekutueshëm e jo dokumentit të besueshëm. Tufje, përmbaruesi privat thekson se pretendimi që gjendja emergjente i kishte pamundësuar palës debitore ushtrimin e prapësimit është i pabazuar sepse debitori kishte pranuar shkresat e lëndës me datën 10.03.2020 ndërsa masat e parë kufizuese janë marrë me datën 15.03.2020. Në anën tjetër komunikimi i prapësimit ka mundur të bëhet edhe përmes postës elektronike të cilën debitori e kishte në dispozicion në zbatim e pranuar. Përmbaruesi privat paashtu përshkruan veprimet të cilat ishin ndërmarr dhe propozon Komisionit që ta refuzoj ankesën si të pabazuar në pajtim me nenin 374 par 1 të LPP-së.

Me datën 27.08.2020, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesionet të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore; dhe përmbaruesit privat _____ Pala ankuese është ftuar në mënyrë të rregullt por nga fletëkthesa nuk rezultoi që e njëjta ka pranuar ftesën. Megjithatë, pala ankuese sipas njoftimit të përfaqësueses së Ministrisë së Drejtësisë është kontaktuar përmes telefonit nga zyrtarët e Ministrisë së Drejtësisë, dhe e njëjta ka konfirmuar pjesëmarrjen por nuk ka prezentuar dhe nuk e ka arsyetuar mungesën.

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesionet të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, ka bërë shpjegimin e propozimit për

fillimin e procedurës penale ndaj përbaruesit privat duke theksuar se bazuar në ankesën e paraqitur nga pala ankuese me shkrim, këtu përbaruesi privat ka bërë shkelje disiplinore nga neni 367 par 1, nën par 1.1, 1.2, 1.4 dhe 1.7 të LPP, me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përbarimore lidhur me lëndën P.nr 258/20, si dhe ka tejkalluar autorizimet e tij ligjore.

Përbaruesi privat deklaron se nuk qëndrojnë pretendimet e palës ankuese se, organi përbarues, në ndonjë mënyrë, kishte vepruar në kundërshtim me ligjin në raport me palën ankuese përkatësisht kishte tejkalluar autorizimet e tyre. Përbaruesi privat thekson që, përbarimi është inicuar me datën 06.03.2020 me propozimin e kreditorit të dt 05.03.2020 mbi bazën e aktgjykimit kurse pala ankuese të njëjtin e ka pranuar me datën 10.03.2020 bazuar në fletë kthesat që gjinden në shkresë e lëndës. Kurse masat e para kalifuzese për sa i përket pandemisë kanë filluar me datën 15.03.2020 përkatësisht me datën 23.03.2020, siç vërtetohet edhe nga vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, të cilit ia paraqesin Komisionit si provë. Me datën 12.05.2020 organi përbarues ka pranuar prapësimin e debitorit përmes postës dhe me datën 15.05.2020, shkresat e lëndës janë dorëzuar në gjykatën kompetente për vendosje. Tutje, përbaruesi thekson se me datën 01.06.2020 janë njoftuar se debitori ka mjete për të përmbushur në tërësi borxhin dhe shpenzimet procedurave dhe në të njëjtën datë është nxjerrë konkluzioni për transfer të mjeteve. Me datën 02.06.2020 është bërë lirimi i llogarive bankare dhe automjeteve të bllokua.

Komisioni gjatë procedurës së administrimit të provave ka lexuar: prapësim të dt 12.05.2020; Profili i Klientit në MLB dt 23.06.2020; urdhëri për përfundimin e procedurës përbarimore dt 02.07.2020; Konkluzioni për transfer periodik dt 17.06.2020; Konkluzion për transferim të mjeteve dt 01.07.2020; Konkluzioni 05.05.2020 Konkluzioni për bllokimin e llogarive bankare; përgjigjja në ankesë dt 25.06.2020; Konkluzion për lirimin e llogarisë dt 02.07.2020; shënim zyrtar 15.05.2020; Aktgjykimi C.nr 1852/11 dt 03.06.2016; fletëdërgesat -fletëkthimet, aktet përcjellëse dhe komunikimet elektronike; Propozimi për përbarim dt 04.03.2020; Urdhëri për përbarim dt 06.03.2020 dhe Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr 01/15 të dt 23.03.2020.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në secënën mënjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se i përbaruesi nuk ka kryer veprën e pretenduar disiplinore.

Komisioni gjën përbarimi ishte inicuar mbi bazën e aktgjykimit të formës së prerë dhe të ekzekutueshëm C.nr 1852/12 të dt 03.06.2016. Pas pranimit të propozimit për përbarim të dt 05.03.03.2020, përbaruesi me datën 06.03.2020 kishte lejuar përbarimin kurse urdhëri për përbarim ishte pranuar me datën 10.03.2020 nga ana e palës debitore, këtu palës ankuese. Pala ankuese pretendon që ia kishte pamundësuar ushtrimin i të drejtës së ushtrimit të mjetit juridik-prapësimin. Fakti se përbaruesi kishte inicuar procedurën përbarimore, në vlerësimin e Komisionit, nuk nënkupton që përbaruesi i ka pamundësuar palës ankuese ushtrimin e mjetit juridik. Mbi përbaruesit privat rëndon obligimi që të ndërmarrin veprimet ligjore për përbarimin çdo herë kur plotësohen kushtet e përcaktuara ligjore. Në rastin në fjalë, kur është paraqitur propozimi për përbarim, përbaruesi nuk kishte asnjë arsye të refuzonte lejimin e tij.

Pala ankuese nuk ka paraqitur asnjë provë e vëllë e bënë iniciimin e procedurës përmbartimore nga ana e përmbartuesit të paligjshëm. Fakti se pas iniciimit të procedurës përmbartimore janë ushtruar vendime nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës për shkak të gjendjes lidhur me pandeminë COVID-19, nuk i bënë veprimet e përmbartuesit *ab initio* të paligjshme. Përmbartuesi privat kishte lejuar përmbartimin para se një vendim i tillë të ndërmirtoj nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Kur përmbartuesi kishte lejuar përmbartimin ai nuk kishte mundësi të parashihete se që të ardhmen masa të tilla do të ndërmerren. Për sa i përket masave kufizuese të lëshuara nga Qeveria e Kosovës, pala ankuese ka në dispozicion mjete juridike për të ushtruar të drejtën e tij për kthimin e aftit në rast se konsideron që si rezultat i masave kufizuese të ndërmirra nga Qeveria e Republikës së Kosovës, është afektuar në ndonjë mënyrë në realizimin e të drejtave të tij të përcaktuara me ligj për shkak që gjendjes emergjente. Është e rëndësishme të theksohet që Procedurat disiplinore pranë komisionit nuk janë procedura shtesë të procedurave gjyqësore apo zëvendësuese të tyre ku palën adresojnë pretendimet ligjore për të cilat parimisht vendos gjykatë. Rrjedhimisht, Komisioni vlerëson se pretendimin e palës ankuese si të pabazuar. Për sa i përket asaj se përmbartuesi privat kishte bllokuar llogarinë e tij bankare në kundërshtim me nenin 48 par 2 të LPP që përcakton "që përmbartimi mbi bazën e dokumentit të besueshëm nuk mund të kryhet para se të marrë formë të prerë aktiviteti për përmbartim." Komisioni vlerëson që këtë çështje pala ka mundur ta adresoj pranë gjykatave kompetente. Komisioni nuk është institucion ku pala agrisin çështje lidhur me interpretimin e dispozitave ligjore. Rrjedhimisht, Komisioni vlerëson se pretendimin e palës ankuese si të pabazuar.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendos si në dispozitiv të këtij vendimi:

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARTUESIT PRIVAT
DPL.nr14/2021, datë 27.08.2020

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adina USTRI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativë bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.